



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

RAPORT

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE

Tetovë, 2025

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEUVALUIMIT	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT	4
2.1. Historiku	4
2.2. Misioni	5
2.3. Zhvillimi strategjik në nivel të programeve studimore të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë.....	5
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT	11
3.1. Organogrami	11
3.2. Programet studimore	12
3.3. Vlerësimi i planprogramit në nivel të programeve studimore	13
4. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR	17
<u>5. ANKETIMI I STUDENTËVE.....</u>	19
6. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESEMARRJA NËPROJEKTE	23
7. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE	25
8. SWOT ANALIZA.....	27
9. KONKLUDIM	29

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT

Vetevaluimi i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë është pjesë e procesit të evaluimit të cilësisë dhe pjesë e procedurës së akreditimit në përputhje me aktet ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky proces është mjaft i rëndësishëm në ndjekjen e vazhdueshme të kualitetit, si dhe analizën dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe hulumtuese të fakultetit, konkluzionet e të cilit na japin një pasqyrë për përmirësimin dhe avancimin e nivelit të cilësisë së procesit të përgjithshëm mësimor dhe shkencor.

Qëllimet kryesore të procesit të vetevaluimit janë:

- ✓ Të vlerësojë në mënyrë të drejtë punën dhe procesin mësimor-shkencor të fakultetit, hulumtimet shkencore dhe rrethanat që lidhen me përmbushjen e këtyre obligimeve;
- ✓ Të identifikojë dhe analizojë përparësitë dhe mangësitë e fakultetit, mundësitë dhe pengesat e zhvillimit dhe njëkohësisht të ndërmarrë masa për korrigjimin dhe tejkalimin e dobësive, si dhe ngritjen e nivelit të cilësisë së procesit mësimor-shkencor të fakultetit;
- ✓ Të japë siguri të plotë për realizimin e procesit të vetevaluimit dhe akreditimit të programeve studimore të fakultetit.

Qëllimi i vetevaluimit është që të analizojë dhe vlerësojë kualitetin e punës së procesit mësimor-shkencor dhe zhvillimin e fakultetit në të gjitha sferat. Kjo analizë do të mundësojë të përcaktohen përparësitë dhe dobësitë e fakultetit dhe planifikimin e masave dhe strategjive që do të ndërmerren për të rritur progresin dhe për të përmirësuar pikat e dobëta të tij. Këto aktivitete, në masë të madhe, do të ndikonin në punën e mësimitdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve në aspektin e zhvillimit dhe aplikimit të modeleve bashkëkohore të mësimitdhënies.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Shkencat Mjekësore në kuadër të Universitetit të Tetovës datojnë që nga periudha e themelimit të tij. Farmacia është programi i parë studimor i FSHM-së që u hap që në vitin 1996, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Matematike -Natyrore. Rreth pesë vite më vonë, respektivisht gjatë vitit akademik 2000/2001, u themelua edhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, me dy programe studimore, edhe atë: programi studimor Mjekësi e përgjithshme dhe Stomatologji.

Me miratimin e Ligjit për themelim të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit të Tetovës, në gjuhën shqipe u themeluan katër njësi akademike, me ç'rast programet studimore të FSHM-së mbeten jashtë përfshirjes në këto njësi. Në atë periudhë u nënshkrua marrëveshje ndërshtetërore mes tre ministrive të arsimit edhe atë të Republikës së Maqedonisë Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me qëllim që studentët të cilët kishin filluar studimet në programet studimore të FSHM-së të transferoheshin në universitetet e tyre. Marrëveshja kishte synim që studentët e viteve të para të transferoheshin në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, vitet e dyta në Universitetin e Prishtinës, kurse vitet e treta dhe të katërta në Universitetin e Tiranës.

Në vitin 2008, u miratua Ligji i ri për Universitetin e Tetovës, me të cilin u ndryshua dhe u plotësua Ligji i vitit 2004. Me këto ndryshime, Universitetit të Tetovës iu shtua edhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore (FSHM-ja), i cili u aprovua si fakultet i veçantë, fillimisht me katër programe studimore, edhe atë: programi studimor Farmaci, Infermieri, Akusheri dhe Fizioterapi, kurse gjatë vitit akademik 2008/09 u akredituan edhe dy programe studimore, respektivisht Mjekësi e përgjithshme dhe Stomatologji.

Në vitin 2013/2014 janë riakredituar të gjitha programet studimore të FSHM-së. Në vitin 2016 janë akredituar edhe studimet e doktoraturës në shkencat biomjekësore. Të arriturat bashkëkohore dhe ato profesionale e shkencore të shkencave mjekësore, sot mjekësinë e trajtojnë si shkencë interdisiplinare që studion dhe arrin që t'i zgjidhë problemet e ndryshme në fushën e shëndetësisë. Duke pasur parasysh faktin se në Republikën e Maqedonisë se Veriut, kemi kuadro deficitare si në aspektin profesional ashtu edhe në atë shkencor, në kuadër të Universitetit të Tetovës funksionon Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë i cili ka për synim dhe mision formimin dhe krijimin e kuadrove me standarde të larta

profesionale dhe shkencore, që do të jenë të gatshëm dhe të aftë të inkuadrohen në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga fushat e mjekësisë.

2.2. Misioni

FSHM bën përpjekje maksimale që të zgjerohet me programe të reja studimore, laboratorë të rinj shkencorë dhe profesionalë, departamente dhe reparte të reja që do të jenë shtyllat kryesore të FSHM-së dhe Spitalit Klinik të Tetovës, institucioneve shëndetësore shtetërore dhe private në Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë. Një iniciativë e tillë është ngritur në drejtim të themelimit të departamenteve në kuadër të FSHM-së. Një organizim i këtillë i fakultetit do të sjellë risi, do të jetë me perspektivë dhe para së gjithash, do të avancojë një organizim të mirëfilltë funksional dhe profesional të Fakultetit të Mjekësisë. Gjithashtu, ka iniciativa në bashkëpunim me Spitalin klinik të Tetovës dhe Ministrinë e Shëndetësisë që, përveç 7 specializimeve në mjekësi që janë akredituar deri më tani, në bazë të nevojave të Spitalit, të përpilojmë elaborate dhe të akreditojmë edhe specializime të lëmive tjera.

Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë do të kontribuojë në planin kërkimor-shkencor, profesional dhe ngritjen e vetëdijes shëndetësore tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë.

2.3. Zhvillimi strategjik në nivel të programeve studimore të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë

Duke pasur parasysh faktin se në kuadër të Universitetit të Tetovës funksionon FSHM me programet studimore: Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji, Farmaci, Infermieri, Fizioterapi dhe Akushi dhe me tendencë edhe të hapjes së programeve të reja studimore, të departamenteve dhe reparteve të reja, të cilat kanë një ngjashmëri shumë të madhe organizative në natyrën e punës praktike dhe teorike, dhe duke pasur parasysh gjithashtu se këto programe studimore dhe fusha shkencore janë në fillim të procesit të zhvillimit dhe organizimit të mëtutjeshëm të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, një organizim i tillë kërkon një investim kapital në kompletimin e mirëfilltë hapësinor, material dhe kadrovik, prandaj e shohim të arsyeshme të propozojmë ***Elaboratin për strategjinë zhvillimore të***

Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, si koncept qendror dhe organizativ i fakultetit, dhe në formimin e **departamenteve**, në kuadër të të cilave do të funksionojnë repartet e përbashkëta, ndërsa si njësi organizative do të funksionojnë laboratorët shkencorë dhe laboratorët mësimorë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë. Koncepti i tillë i zhvillimit strategjik dhe organizativ i Fakultetit të Mjekësisë, në organizimin e **departamenteve**, në kuadër të të cilëve do të funksionojnë repartet e veçanta, dhe ngritja e laboratorëve hulumtues shkencorë dhe laboratorëve qendrorë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë dhe të programeve studimore, e departamenteve përkatëse, do të sjellë një risi dhe progres të veçantë në funksionimin dhe mbarëvajtjen me sukses të mësimin të pjesës praktike dhe teorike, të lëndëve mësimore që kanë një ndërlidhshmëri të ngushtë funksionale në realizimin e pjesës teorike dhe praktike në këtë fakultet. Ky koncept i organizimit bëhet me të vetmin qëllim që të mund të bëhet kompletimi më i shpejtë dhe i duhur i departamenteve dhe laboratorëve, konform standardeve bashkëkohore që i kërkon puna praktike laboratorike dhe teorike, bashkëpunimi dhe ndërlidhshmëria e disiplinave shkencore në fusha të caktuara shkencore dhe profesionale, efikasitetin dhe kontrollin sa më të madh në punë.

Programi studimor Mjekësi e përgjithshme

Në vitet e kaluara, mësimi në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë është realizuar në bazë të planit dhe programit të pranuar nga komisionet përkatëse të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në studimet bazike dhe ato klinike janë punësuar punëdhënës në bazë të nevojave specifike dhe të kualifikuar për lëndët përkatëse.

Në të ardhmen afatmesme pesëvjeçare, theksi i veçantë do të vendoset në formimin e katedrave dhe instituteve të Fakultetit të Mjekësisë, punësimin e kuadrove asistentë doktorantë në shkencat bazike, dhe atë një për çdo lëndë të instituteve të mjekësisë, dhe furnizimi i instituteve me aparaturë moderne, në pajtim me sylabusët përkatës dhe nevojat aktuale. Çdo asistent doktorant i institutit do të jetë i obliguar që të ndjekë në vazhdimësi trajnimet e parapara nga fakulteti dhe kompanitë që bëjnë furnizimin me aparaturë përkatëse dhe të mos specializojë ndonjë degë të mjekësisë e cila nuk është komplementare me lëndët në të cilën është i angazhuar. Nga radhët e asistentëve, të zgjidhet një përgjegjës i instituteve, i cili do të merret me furnizimet e laboratorëve dhe nevojave të kolegëve të tjerë të angazhuar në institute, për shkak të afërsisë së tij me punën në laboratorë dhe me studentët, dhe njëkohësisht njohurive të tij me kualitetin e punës në institute. Për sa i përket lëndëve klinike,

hapësirat e Spitalit Klinik janë të mjaftueshme dhe duhet të punohet në trajnimin e kuadrove, në bashkëpunim me udhëheqësinë e spitalit dhe rektoratit. Kuadri duhet të jetë nga radhët e specialistëve dhe specializantëve, të cilët do të jenë të gatshëm të ndajnë kohën për edukim profesional sa më të mirë të studentëve. Gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare janë akredituar 7 specializime të mjekësisë, siç janë: specializimi në: kirurgji urologjike, mjekësi interne, kirurgji e përgjithshme, psikiatri, pediatri, gjinekologji dhe kardiologji. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka lidhur memorandum bashkëpunimi me shumë klinika të tjera, me qëllim të bashkëpunimit të ndjekjes së tornuseve të specializantëve nëpër klinikat tjera, siç janë: ISHP Spitali Klinik-Tetovë, ISHP “Klinika Universitare e Urologjisë”-Shkup, ISHP “Klinika Universitare e Neurologjisë” – Shkup, IPSh “Klinika Universitare e Sëmundjeve Respiratore te Fëmijët Kozle”-Shkup, IPSh Spitali Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë "Nëna Terezë" – Shkup, IPSh "Klinika Universitare e Toksikologjisë" – Shkup, Spitali i Përgjithshëm i qytetit "8 Shtatori" – Shkup, ISHP "Instituti Universitar për Biokimi Klinike"-Shkup, ISHP "Klinika Universitare për Sëmundje të Fëmijëve"- Shkup.

Gjithashtu, në pesë vitet e ardhshme duhet të bëhet përpjekje për hapjen e instituteve dhe katedrave në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë.

Programi studimor Stomatologji

Në vitet e kaluara, mësimi në programin studimor Stomatologji është realizuar në bazë të planit dhe programit të pranuar nga komisionet përkatëse të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë aktiviteteve për nxënie, studim dhe realizim të punës janë përdorur laboratorët e pjesës paraklinike, si: laborator i protetikës mobile dhe fikse, laborator i pjesës së kariologjisë i pajisur me fantoma, mjete dhe materiale të veçanta për realizimin e procesit mësimor si pjesë e programit të paraklinikës. Për pjesën e inkuadrimit klinik të studentëve janë shfrytëzuar hapësirat e klinikave dentare dhe specialistike të akredituara për ushtrim detyrë nga dhoma stomatologjike dentare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjithsesi dhe klinikave dentare që kanë lidhur kontratë bashkëpunimi me Fondin për Sigurim Shëndetësor. Në disa raste janë përdorur dhe hapësirat e klinikës universitare stomatologjike Shën Pantelejmoni në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim në të gjitha nivelet arsimore, shkencore dhe hulumtuese. Në pesë vitet e ardhshme theksi duhet të vendoset në krijimin e hapësirave të reja në kuadër të Spitalit Klinik të Tetovës për krijimin e klinikës

stomatologjike duke krijuar kushtet sipas gjitha kriterëve, nevojave dhe kërkesave ndaj hapësirave, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për ushtrim profesional shkencor e hulumtues, gjithashtu duke realizuar dhe kontrata bashkëpunimi edhe me pjesën e kirurgjisë së përgjithshme duke inkuadruar kirurgjinë maksilofaciale. Me krijimin e klinikës stomatologjike do të mundësohet edhe dhënia e shërbimeve mjekësore stomatologjike për qytetarët e regjionit e më gjerë. Me klinikën stomatologjike do të jepet mundësia e dhënies së shërbimeve stomatologjike, specialistike etj. Planifikohet krijimi i katedrave përkatëse stomatologjike, instituteve të fakultetit të stomatologjisë në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë. Si plan projekt do të kemi zgjerimin e kuadrit mësimor, shkencor e profesional për realizimin e gamës së shërbimeve profesionale stomatologjike për pacientët dhe studentët. Gjatë periudhës pesëvjeçare do të aplikojmë për akreditim të ciklit të dytë të studimeve master dhe specializimeve përkatëse stomatologjike sipas programeve të përfshira, si: Studime specialistike stomatologjike. Specializimet e tilla do të jenë të mjaftueshme për shërbim edhe të studentëve të stomatologjisë së bashku me kuadrin e tyre. Është e rëndësishme që në të ardhmen të punësohen profesionistë përkatës për lëndët stomatologjike klinike, në mënyrë që niveli i edukimit të jetë sa më i lartë dhe me theks në punën praktike për studentët e stomatologjisë. Programi studimor i Stomatologjisë gjithashtu ka një bashkëpunim të mirëfilltë me Shtëpinë e Shëndetit në Tetovë, ku studentët kryejnë mësimin praktik.

Programi studimor Farmaci

Programi studimor Farmaci është program i integruar dhe bashkëkohor i studimeve në fushën e farmacisë. Ky program ka përcaktuar kohëzgjatjen e studimeve prej 5 vitesh akademike dhe 300 ECTS. Kjo kurrikulë e programit të studimit të integruar ka misionin e përbashkët me Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës, për një arsimim cilësor dhe zhvillim të kërkimeve shkencore, për të përgatitur kuadro të formuar profesionalisht në fushën e farmacisë.

Përveç kompetencave profesionale që përcaktojnë natyrën e punës së një farmacisti, për kuadrin e ardhshëm përforcohen edhe kompetencat ndërprofesionale, me qëllim që shërbimet farmaceutike që u ofrohen pacientëve të mbeten pikë referente në hap me nevojat. Përforcimi i kapaciteteve profesionale dhe zhvillimi i multidisiplinaritetit janë prioritete strategjike për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës dhe për të garantuar karrierë profesionale konkurruese në tregun global për kuadrin e farmacistit.

Programi studimor i Farmacisë gjithnjë mbetet i orientuar të njihet në shkallë rajonale, evropiane dhe më gjerë. Zhvillimi dhe avancimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore konsiderohet si masë afirmative për përforcimin e potencialit kadrovik dhe vendosjes së standardeve bashkëkohore në veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore.

Format e ndryshme të komunikimit shkencor nga ana e stafit akademik para komunitetit më të gjerë shkencor kanë zënë vend të rëndësishëm në zhvillimin e performancës së këtij programi studimor, duke mbetur të vendosur për të siguruar pjesëmarrje më të madhe në projektet kërkimore-shkencore ndërkombëtare dhe bilaterale, me theks të veçantë me strukturat institucionale brenda shtetit dhe në shkallë evropiane. Programi studimor i Farmacisë do të rrisë prezencën dhe aktivitetet e tij në fushën shkencore nëpërmjet punëve profesionale aplikative.

Në përcaktimin e sfidave dhe hapave të së ardhmes së modernizuar, studentët do të jenë pjesë kryesore. Ata do të përfitojnë nga përgatitja teorike dhe ajo praktike, duke u përfshirë edhe në fushën e kërkimeve shkencore, në aktivitetet profesionale dhe ato aplikative. Që kuadri ynë të jetë konkurrues në tregun e punës, programi studimor i Farmacisë tashmë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani dhe qendra farmaceutike në vend, siç janë: Marveshja me Agjensionin e barnave “Malmed”- Shkup, me kompanitë farmaceutike „Galafarm”, “Trefarm”, “Makedonija lek” si dhe një numër të konsiderueshëm të barnatoreve ku studentët kanë ndjek praktikën profesionale në semestrin e fundit. Në vitin 2024, programi studimor Farmaci u pasurua edhe me një laborator të farmakognozisë, ku u siguruan pajisje me moderne. Mirëpo, programi studimor Farmaci ka shumë nevojë për pajisje më moderne, aparatura si dhe materiale harxhuese, që të mund studentët t’i realizojnë ushtrimet sipas planprogramit të paraparë. Gjetja e mundësive më të mëdha të kyçjes së studentëve në veprimtarinë aplikative farmaceutike mbetet prioritet për të ardhmen.

Programi studimor Infermieri

Drejtimi i Infermierisë ka shfrytëzuar hapësirat e Spitalit Klinik, që janë të mjaftueshme për këtë program studimor. Nevojat kryesore për pesë vitet e ardhshme janë në zhvillimin dhe avancimin e kuadrit mësimor-shkencor në kuadër të këtij drejtimi. Theksi i veçantë duhet të vendoset në punën praktike në lëndët profesionale, me kuadër përkatës nga radhët e infermierëve me përvojë në Spitalin Klinik të Tetovës dhe dërgimin e studentëve që të

njoftohen me metodat e reja praktike, invazive dhe joinvazive, në shtetet fqinje dhe më gjerë, së bashku me stafin edukues. Duhet të investohet në hapësira të veçanta në kuadër të instituteve, që do të jenë të furnizuara me modele për dhënie të terapisë, që studentët do t'i shfrytëzojnë për trajnim para se të ndeshen me rastet e gjalla dhe të jenë sa më të përgatitur për dhënie të ndihmës dhe të evitohet dëmtimi i pacientëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në të ardhmen. Puna në institute duhet të zvogëlohet për këtë fakultet dhe të shtohet puna në reparte dhe puna jashtë hapësirave të Spitalit Klinik, në qendra më të avancuara klinike. Aparaturat më moderne në mjekësi implikojnë domosdoshmërisht edhe trajnim të infermierëve, dhe kjo nevojë duhet të kuptohet sa më herët dhe të realizohet me plan dhe program në këtë drejtim.

Programi studimor Fizioterapi

Programi studimor Fizioterapi në krahasim me programet tjera studimore në kuadër të FSHM-së është më pak i pajisur për sa i përket hapësirave të realizimit të mësimit dhe punës praktike. Në të ardhmen duhet të punohet në drejtim të krijimit të hapësirave të reja për edukim dhe punë praktike për studentët e këtij programi studimor, punësim të kuadrit të përhershëm edukues dhe investimit në mjete dhe trajnim të kuadrit dhe njëkohësisht dhënies së shërbimit mjekësor cilësor fizioterapeutik dhe në kushte bashkëkohore si dhe në përshtatshmëri me nevojat e popullatës. Studentët e këtij drejtimi, së bashku me mësimdhënësit duhet të vizitojnë qendrat më të mëdha fizioterapeutike në shtet dhe më gjerë për të përfituar nga përvojat e mëdha të këtyre qendrave dhe njëkohësisht bartjes së këtyre përvojave në punën e tyre të përditshme.

Programi studimor Akusheri

Programi studimor Akusheri shfrytëzon hapësirat e repartit gjinekologjik në kuadër të Spitalit Klinik, si bazë e mjaftueshme e punës së tyre praktike. Në të ardhmen duhet të investohet në zgjerimin e këtyre hapësirave për studentët e akusherisë dhe punësimin e kuadrove që do të jenë të përhershëm dhe adekuat në procesin e edukimit të studentëve, me theks të veçantë në punën praktike, nga radhët e akushereve me përvojë nga spitali klinik. Duhet të ndërtohen hapësira të veçanta në kuadër të instituteve, të furnizuara me modele përkatëse artificiale që imitojnë procesin e lindjes, me qëllim të mësimit dhe përgatitjes sa më të mirë të studentëve, para se ato të ndeshen me rastet e gjalla dhe njëkohësisht të shmanget

sa më shumë mundësia e dëmtimit të pacienteve gjatë dhënies së ndihmës mjekësore. Studentët, së bashku me stafin edukues, duhet të vizitojnë qendra më të mëdha gjinekologjike akusherike për të përfituar nga përvoja e këtyre të fundit në procesin e lindjes normale dhe atë të asistuar, që këto përvoja t'i bartin në punën e tyre të përditshme.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Struktura organizative e FSHM-së përbëhet nga dekani dhe dy prodekanë, respektivisht prodekani për shkencë dhe prodekani për arsim, dy koordinatorë për ECTS në studimet deridiplomike dhe nga një koordinator për studimet e ciklit të dytë, respektivisht studimeve të ciklit të tretë. Gjithashtu në kuadër të FSHM-së janë të angazhuar gjashtë shefa të programeve studimore përkatëse.

Dekani i implementon autorizimet e përcjella nga ana e Rektorit, i zbaton vendimet e Senatit dhe Rektorit të Universitetit, i aprovon Vendimet e marra nga Këshilli Mësimor-Shkencor, kujdeset për realizimin e veprimtarisë së lartë shkencore-hulumtuese, thirr mbledhjet e Këshillit Mësimor-Shkencor, propozon rendin e ditës dhe udhëheq me mbledhjet, përgatit dhe propozon aktet, materialet dhe çështje për të cilat sjell vendime udhëheqësia e dekanatit.

Këshilli Mësimor - Shkencor parashtro propozime dhe merr vendime për çështje të cilat janë në kompetencë të Këshillit. Udhëheqësisë së Universitetit i propozon hapje të Konkursit për rizgjedhje, në afat prej gjashtë muajsh para afatit të përcaktuar.

Dekani organizon dhe menaxhon punën e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë. Ai një herë në vit i jep raport Këshillit të Rektoratit dhe Rektorit për punën e tij njëvjeçare. Dekani është përgjegjës për punën e organeve të fakultetit. Prodekanët dhe shefat e programeve studimore përkujdesen për mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor.

Në kuadër të FSHM-së funksionon edhe Këshilli i Fakultetit, si organ më i lartë për vendimmarrje, i cili përbëhet nga të gjithë mësimdhënësit e këtij fakulteti që janë në marrëdhënie të rregullt pune dhe që kanë thirrje docent e më lartë dhe dy përfaqësues nga Parlamenti Studentor të cilët kanë të drejtë vote.

Pjesa administrative është e organizuar nga një përgjegjës i administratës dhe 16 referentë.

Për evaluimin e procesit mësimor, FSHM-ja ka formuar komision për vetevaluim i cili përbëhet nga një kryetar dhe katër anëtarë.

3.2. Programet studimore

Programet studimore të FSHM-së në studimet e ciklit të parë janë dizajnuar sipas kriterëve të Deklaratës së Bolonjës, të akredituara në vitin 2013. Kohëzgjatja e studimeve varion nga programi studimor, konkretisht, studimet në programin studimor Mjekësi e përgjithshme zgjasin më së shumti 12 semestra apo gjashtë vite dhe studentët grumbullojnë (360 ECTS kredi) pastaj vijon Stomatologjia dhe Farmacia me 10 semestra apo pesë vite studimore (300 ECTS kredi). Programet studimore tjera janë të akredituara me nga gjashtë semestra apo tri vite studimi (180 ECTS kredi).

Tabela 1. Programet studimore që funksionojnë në kuadër të FSHM-së në studimet e ciklit të parë

Programi studimor	Viti i themelimit	Viti i riakreditimit të parë	Viti i riakreditimit të dytë
Mjekësi e përgjithshme	2008	2013/2014	2021/2022
Stomatologji	2008	2013/2014	2021/2022
Farmacë	2008	2013/2014	2021/2022
Infermieri	2008	2013/2014	2021/2022
Akusheri	2008	2013/2014	2021/2022
Fizioterapi	2008	2013/2014	2021/2022

FSHM funksionon me të gjitha ciklet e studimeve, respektivisht ciklin e parë, me gjashtë programe studimore, studimet e ciklit të dytë- studimet specialistike njëvjeçare dhe studimet specialistike të Mjekësisë 6 vjeçare si dhe ciklin e tretë të studimeve, respektivisht në shkencat biomjekësore.

Studimet në Mjekësi dhe Stomatologji paraqesin studime sipërore profesionale nga fusha e shkencave të mjekësisë ,në kohëzgjatje prej 5 dhe 6 vitesh.

Studimet e Farmacisë janë të orientuara në atë mënyrë që t'i mundësojnë studentit të diplomuar kompetenca të larta për punë në fushën shëndetësore, përmes diturive të fituara nga lëmi e barnave, mënyrës bashkëkohore të shërimit dhe ndikimit klinik të tyre.

Nga ana tjetër, nga njohuritë për lëndët nga kimia analitike dhe sintetike, studentëve të diplomuar u jep njohuri për punën në industrinë farmaceutike, në laboratorë hulumtues, laboratorë analitikë, laboratorë tjerë për prodhimin e barnave dhe mjeteve të tjera ndihmëse për shërim, institucionet për regjistrimin e barnave etj.

Të diplomuarit në drejtimin e Infermierisë, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me mjekun, janë bashkëpunëtorë shëndetësorë në repartet spitalore të klinikave të përgjithshme, shtëpive të shëndetit ose në ambulanca (publike apo private). Të diplomuarit në drejtimin e

Akusherisë, në bashkëpunim direkt me mjekun specialist për akusheri, janë punëtorë shëndetësorë përgjegjës për kujdesin shëndetësor të grave shtatzëna.

Të diplomuarit në drejtimin e Fizioterapisë, në bashkëpunim direkt me mjekun specialist të fizioterapisë, janë punëtorë shëndetësorë përgjegjës për strukturat shëndetësore (publike apo private), kujdesit shëndetësor, edukimit fizik dhe kujdesit fizik.

Tabela 2. Programet studimore të ciklit të dytë dhe të tretë

Cikli i studimeve	Programi studimor	Viti i themelimit
Cikli i dytë	Farmaci	2008
Cikli i tretë	Biomjekësi	2016
Cikli i dytë	Studimet specialistike një vjeçare dhe 6 vjeçare	2024
Cikli i dytë	Studimet specialistike 6 vjeçare	2024

Studimet e ciklit të dytë zgjasin 4 semestra me 120 ECTS kredi, ndërsa studimet e ciklit të tretë 6 semestra me 180 ECTS kredi, kurse studimet specialistike njëvjeçare zgjasin dy semestra ato 6 vjeçare zgjasin 12 semestra.

3.3. Vlerësimi i planprogramit në nivel të programeve studimore

Programi studimor Farmaci

- a) Në kuadër të programit studimor Farmaci, prej 44 lëndëve obligative, rreth 77% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, një lëndë është pjesërisht në përputhshmëri, kurse 10 lëndë¹ nuk janë në përputhshmëri me programin sipas klasifikimit të lartpërmendur. Sa u përket lëndëve zgjedhore, prej 42 lëndëve, rreth 93% janë plotësisht në

përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, 3 lëndë janë pjesërisht në përputhshmëri, kurse 1 lëndë nuk është aspak në përputhshmëri me klasifikimin e lartpërmendur.

- b) Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus.

Programi studimor Fizioterapi

- a) Në kuadër të programit studimor Fizioterapi, prej 28 lëndëve obligative, rreth 89% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, një lëndë është pjesërisht në përputhshmëri, si dhe një lëndë nuk është në përputhshmëri me fushën e programit sipas klasifikimit të lartpërmendur. Prej 12 lëndëve zgjedhore, rreth 67% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, kurse 5 lëndë janë pjesërisht në përputhshmëri sipas klasifikimit të lartpërmendur.
- b) Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus. Të gjitha lëndët kanë zhvillim të kompetencave, në përjashtim të një lënde obligative që nuk ka aspak zhvillim të kompetencave.

Programi studimor Infermieri

- a) Në kuadër të programit studimor Infermieri, prej 33 lëndëve obligative, rreth 85% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, 1 lëndë është pjesërisht, si dhe 4 lëndë nuk janë në përputhshmëri, me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të lartpërmendur. Sa u përket lëndëve zgjedhore, prej 12 lëndëve, rreth 67% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, 1 lëndë është pjesërisht, kurse 3 lëndë nuk janë në përputhshmëri, me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të lartpërmendur.
- b) Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus. Prej 45 lëndëve obligative, 2 lëndë nuk kanë aspak zhvillim të

kompetencave, kurse prej 2 lëndëve zgjedhore, një ka pjesërisht zhvillim të kompetencave dhe një lëndë nuk ka aspak zhvillim të kompetencave.

Programi studimor Stomatologji

- a) Në kuadër të programit studimor Stomatologji, prej gjithsej 67 lëndëve obligative, rreth 96% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, ndërsa 3 lëndë janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor. Sa u përket lëndëve zgjedhore, prej 16 lëndëve zgjedhore, rreth 31% janë plotësisht në përputhshmëri, 8 lëndë janë pjesërisht, kurse 3 lëndë nuk janë aspak në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të lartpërmendur.
- b) Kompetencat e definuara në deskriptorët e përgjithshëm të programit studimor, studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në sylabus. Një pjesë e caktuar e lëndëve (9% obligative dhe 6 % zgjedhore) kanë pjesërisht zhvillim të kompetencave, kurse lëndët tjera, përfshirë ato obligative dhe zgjedhore, kanë plotësisht zhvillim të kompetencave.

Programi studimor Studime specialistike për shëndet mental

Në kuadër të programit studimor Studime specialistike për shëndet mental, prej 6 lëndëve obligative, rreth 78% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, ndërsa 22% e lëndëve janë pjesërisht në përputhshmëri. Sa u përket lëndëve zgjedhore, prej 4 lëndëve, rreth 85% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar; të Fraskatit, 15% e lëndëve janë pjesërisht në përputhshmëri.

Programi studimor Kujdes familjar dhe patronazh

